



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2871 Prot.

Durrës, më 14/05/2020

URDHËR

Nr. 145, Datë 14.05.2020

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES
SHPRESA SKRAME”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1. shkronja “a)”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, nisur nga administrimi i kërkesës së noterës Shpresa Skrame për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, administruar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. Sh-10 prot., datë 02.03.2020,

KONSTATOJ:

Përmes shkresës së administruar nga Ministria e Drejtësisë me nr. Sh-10 prot., datë 05.03.2020, noterja Shpresa Skrame, e cila ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Lejen nr. 194 datë 17.10.1998 të Ministrit të Drejtësisë “Për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe përcaktimin e njesisë vendore të ushtrimit të veprimtarisë noteriale, ka paraqitur kërkesën e saj për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.

Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë” në nenin 21, gërma “a”, parashikon heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit përmes Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri heq dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, me kërkesën e tij.

Sipas nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe konkretisht pikës 1 dhe 2 të tij, në rast të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të një zyre noteriale, arkivi i noterit në largim merret nga noteri që plotëson vendin vakant. Nëse një vend vakant mbetet i paplotësuar, dega vendore përkatëse e Dhomës përzgjedh një tjetër noter në atë bashki për të marrë përsipër arkivin, në bazë të përzgjedhjes me short. Dega vendore përkatëse mund të zgjedhë një noter të propozuar nga noteri në largim. Në çdo rast, noteri i zgjedhur ka për detyrë të marrë përsipër arkivin.

Përmes Udhëzimit Nr.6291, datë 17.8.2008 të Ministrit të Drejtësisë “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave

noteriale", përcaktohet në mënyrë të detajuar procedura e marrjes në dorëzim të arkivit të noterit në rastet e heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit të noterit nga Ministri i Drejtësisë.

Sa më sipër nisur nga administrimi i kërkesës së noteres Shpresa Skrame, për heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit si dhe në respektim të parashikimeve të akteve Ligjore e nënligjore në fuqi për noterinë dhe në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, nenit 7 pikës 2. të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 21, pika 1. shkronja "a)", dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Shpresa Skrame, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Durrës, për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Anairda Arizaj, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Znj. Greis Çomo Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Durrës, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri.
 - d) Një noter i caktuar nga Dhoma e Kombëtare e Noterisë, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Shpresa Skrame, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë, dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.
7. Dhoma e Noterisë Durrës, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, si dhe pas konsultimit me znj. Shpresa Skrame, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë".
8. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 7. të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga dhoma përkatëse e noterisë, brenda 5 ditëve pune.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Konceptoi: A. Arizaj
Pranoi: E. Pajnikaj
Konfirmoi: A. Shehu
Miratoi: G. Ipeva
Datë: 6/koje/05.03.2020 riprintuar 13.04.2020/riprintuar 27.04.2020 riprintuar 27.04.2020